

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Enver Robelli - Edi Rama po e keqpërdor Kosovën si lavatriçe për hallet e tij
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919275/edi-rama-po-e-keqperdor-kosoven-si-lavatrice-per-hallet-e-tij/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:35:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 08:09:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5fc57e1d5b29db32e60a81ac616bb7e577ab9f3e123ffb322e14c1ed99dd6088
TEKSTI	43948e95eb73da8d48955029c1f7d5784e0a26debef97e690fe5bfd9de32f9f0
PAMJA	0628b11073aa21f51f198c3a8282bcb2786239d57caaeb5e6576c6fdb55f82f4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	230eaf01f88a62fa7589267a2467764862cdebc0dcb5ea435cf314db90e9711b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ae6abf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/230eaf01f88a62fa7589267a2467764862cdebc0dcb5ea435cf314db90e9711b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**
Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve**ENVER BYTYÇI**
Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin

Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës

Edi Rama po e keqpërdor Kosovën si lavatriçe për hallet e tij

10:09, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Enver Robelli

Tash Edi Ramës i mbetet vetëm të kërkojë që rrugës Ferizaj-Gjilan t'i hiqet emri i të birit të Joe Biden. Me propozim të ministres Diella kjo rrugë në Kosovë do të bart emrin e një djali jobiologjik të Edi Ramës. Quhet: Ergys Agasi.

Edi Rama është në hall të madh: shteti i tij tashmë është shpalosur si një korporatë në shërbim të krimit të organizuar! Grupe të ndryshme brenda sistemit që kanë zhvatur kudo ku kanë arritur po luftojnë njëri-tjetrin pamëshirshëm. Bandat kanë depërtuar në palcë të sistemit. Kur shikohet lista e zyrtarëve të arrestuar, të shpallur në kërkim, të dënuar - Shqipëria shfaqet si një republikë bananesh me deputetë që në Kuvend janë thjesht instrumente të brigadave për tregti me drogë. E tillë Shqipëria s'i duhet as BE-së, as vetvetes.

Në këtë situatë dramatike, Edi Rama bën atë që bën përherë: e keqpërdor Kosovën si lavatriçe për hallet e tij, për shpërqendrim vëmendjeje dhe prodhim mjegulle patriotike.

Gjatë qëndrimit në SHBA me rastin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e akuzoi Joe Bidenin se e paskësh tradhtuar Hashim Thaçin lidhur me Gjykatën Speciale.

Por, në dredhite e tij Edi Rama e heshti faktin kryesor: në korrik 2015 ai erdhi urgjentisht nga Tirana në Prishtinë me kërkesën këmbëngulëse që parlamenti ta themelonte Gjykatën Speciale. Tha se kjo ishte kërkesë e partnerëve perëndimorë, pra edhe e Joe Bidenit.

Si është e mundur ta akuzosh më 2026 Joe Bidenin e më 2015 të vish në Prishtinë si përkrahës i tij për themelimin e Gjykatës Speciale? Dje misionar i Gjykatës Speciale, sot mallkues i saj. Edi Rama e bën këtë. Sepse nuk ka asnjë skrupull. I duhen këto metafora të qullëta për përdorim të brendshëm popullit.

Joe Biden nuk është më në pushtet, andaj është lehtë të hidhen akuza të tilla. Përkundër rolit të administratës së demokratëve në themelimin e Gjykatës

Speciale, ish-presidenti Thaçi u arrestua gjatë qeverisjes së Donald Trumpit dhe u dënua gjatë mandatit të dytë të Trumpit. Por këtë Edi Rama nuk e përmendi në fjalimin e tij në New York. Ai bëhet i fortë vetëm ndaj atyre që nuk kanë pushtet dhe i përkasin të kaluarës, andaj s'paraqesin ndonjë kërcënim për pushtetin e tij. Edhe Trumpin e quante rrezik për botën para se të fitonte zgjedhjet e para presidenciale (te ajo intervista famoze e Ramës në CNN e vitit 2016, ku shtirej si zëdhënës i botës liberale). Tash Trumpin e quan fat për Europën.

Presioni nga administrata e Barack Obamës dhe pastaj Joe Bidenit ndaj Kosovës lidhur me Gjykatën Speciale mund të ketë qenë i madh dhe, përballë kësaj situatë, Thaçi u dorëzua më 2015. Por kur Thaçi filloi ta kritikonte Gjykatën Speciale më 2019, reagimi i ministrit të Jashtëm amerikan Mike Pompeo ishte po ashtu i ashpër. E Pompeo ishte kryediplomati i Donald Trumpit.

Në fund të vitit 2019, Thaçi i shkroi Pompeo se "institucionet e Kosovës i janë tepër mirënjohëse Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në veçanti Zyrës për Drejtësi Globale Kriminale të Departamentit të Shtetit, për mbështetjen e vazhdueshme politike dhe financiare për etablimin e mandatit të Dhomave të Specializuara të Kosovës", por, njëkohësisht, u ankua se Gjykata Speciale është monoetnike dhe po i heton vetëm shqiptarët.

Pompeo u përgjigj pas disa javësh. Në letrën dërguar Thaçit në prag të 12-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, Pompeo shkroi se "heqja ose dëmtimi i strukturës së punës ose lokacionit të Dhomave të Veçanta ose Prokurorisë së Specializuar, në çfarëdo mënyre, do ta dëmtonin seriozisht kredibilitetin dhe reputacionin ndërkombëtar të Kosovës. (...) Puna e Dhomave të Veçanta në formatin aktual është mënyra më e mirë që Kosova ta mbyllë këtë kapitull në historinë e saj".

Të gjitha këto fakte Edi Rama i injoroi, sepse atij i intereson vetëm loja me fjalë. Thaçin dhe "tradhtarin Biden" ai i përmendi në mbrëmjen gala të organizuar nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane në New York. Ishte një fjalim mes bashkëatdhetarëve. Pastaj mbajti fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Aty - në forumin vjetor të politikës botërore - Kosovën s'e përmendi fare. Foli vetëm për inteligjencën artificiale. Foli për Diellën. Ministren e tij digjitale. Prej Diellës pritej se do të luftonte korrupsionin. Ndërkohë, në burg kanë përfunduar shpikëset e Diellës. Në fjalimin e tij në OKB Rama nuk përmendi rolin destrktiv të Serbisë në rajon, siç bëri kryeministri kroat. Nuk përmendi festimet nacionale serbe gjatë gropës së kriminelit të luftës Ratko Mlladiq, siç bëri kryeministri kroat. Nuk përmendi as sulmin terrorist të Millan Radojçiqit me bandën e tij para tri vitesh në veri të Kosovës, me ç'rast u vra një polic dhe u plagosën disa të tjerë.

Në vitin 2023 një fushatë e zhurmshme paramediale tentoi ta bindte opinionin në Kosovë se Edi Rama, me një fjalim para Këshillit të Evropës, do ta bënte shkrumb e hi Raportin famëkeq të Këshillit të Evropës, do ta hidhte në ajër Gjykatën Speciale dhe do t'i qortonte ashpër pizevengët perëndimorë që krijuan këtë monstrum juridik.

Edi Rama e mbajti fjalimin para Këshillit të Evropës. U paralajmërua se Tirana do të shtynte një rezolutë në Këshillin e Evropës mbi këtë çështje. A ka ndodhur diçka ndërkohë? E shkuar, e harruar. Madje, fjalimi mund të ketë dëmtuar ambiciet e Kosovës për hyrje në Këshillin e Evropës.

Kështu duken fshatrat e Potemkinit të Edi Ramës: iluzion, mashtrim, fasadë. I përshtaten edhe motos që mund të lexohet në ueb-faqen e Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH): "Ne jemi aty ku të tjerët nuk janë, sigurojmë informacione që të tjerët nuk i kanë dhe bëjmë më të mirën për sigurinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve".

Në përkthim në gjuhën shqipe, kjo domethënë: jemi në shërbim të krimit të organizuar aty ku shqiptarët nuk e presin dhe bëjmë më të mirën për rehatinë e banditëve.

Tash Edi Ramës i mbetet vetëm të kërkojë që rrugës Ferizaj-Gjilan t'i hiqet emri i të birit të Joe Biden. Me propozim të ministres Diella kjo rrugë në Kosovë do të bart emrin e një djali jobiologjik të Edi Ramës. Quhet: Ergys Agasi.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Tradhtari ka vetëm një emër!



Asnjë fjalë për Kosovën në OKB, ndërkohë Rama përgatit rezolutë për mbrojtjen e homoseksualëve



Tabaku: Korrupsioni është taksa e fshehtë që paguan çdo shqiptar

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



Arrestimi i Vlorë Hysenit/ Gjunksi:
Jo vetëm çështje faji, duhen parë
përgjegjësit për emërimin




SYRI TV/ Pikëpyetje për shpenzimet
në Portin e Durrësit, 178 mijë euro
për panele, 88 mijë euro humbje



Monologu ...i atyre që i ikin!



Si e fyeu Edi Rama, 'Makiaveli
shqiptar', Asamblenë e Përgjithshme
të Kombeve të Bashkuara



Rama zhgënjën mediat në Prishtinë:
Kosova pa zë në OKB, asnjë fjalë për
UÇK-në



Mbyllet protesta e 118/ Qytetarët të
vendosur deri në largimin e Ramës:
Nesër më shumë!



'Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty'/
Kush mban përgjegjësi për skandalin
e SHISH?

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.